



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr./Si.

Data/Datum.

348/19

06.08.2019

PSH.nr. 348/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Virtuo” O.P- Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese të TI-së, si dhe Furnizim me pajisje përcjellëse për nevojat e AKKVP-së” me nr. prokurimit: 329-19-3253-1-1-1, të iniciuar nga AK- Agjencia Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, më datë: 26.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Virtuo” O.P- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese të TI-së, si dhe Furnizim me pajisje përcjellëse për nevojat e AKKVP-së” me nr. prokurimit: 329-19-3253-1-1-1, të iniciuar nga AK- Agjencia Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues / Agjencia Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës /, ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje e tenderit, në pajtim nenit 53.7 të LPP-së, dhe ti merre parasysh rekomandimet e ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertit shqyrtues, lidhur me aktivitetin të prokurimit “Zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese të TI-së, si dhe Furnizim me pajisje përcjellëse për nevojat e AKKVP-së” me nr. prokurimit: 329-19-3253-1-1-1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Virtuo” O.P- Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimi për kontratë është bërë me dt: 20.05.2019.

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është bërë me dt: 28.06.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 20.06.2019.

Data e vendimit të AK-së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 21.06.2019.

Operatori ekonomik ankues: “Virtuo” O.P- Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 01.07.2019, me nr.348/19, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese të TI-së, si dhe Furnizim me pajisje përcjellëse për nevojat e AKKVP-së” me nr. prokurimit: 329-19-3253-1-1-1, të iniciuar nga AK- Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës , duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe nenin 19.dhe 20 ,të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 02.07.2019, ka autorizuar ekspertin e jashtëm teknik dhe ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti i jashtëm teknik dhe eksperti shqyrtues, në raportin e dt: 04.07.2019, Sqaron se- Autoriteti Kontraktues - Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës – Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti

të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër specifikimeve teknike në aneksin 1 të Dosjes së Tenderit. Kundër njoftimit për kontratë parashtruesi i ankesës OE - Virtuo O.P. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me datë 20.06.2019. Me datë 21.06.2019 AK ka nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me pretendimet e njëjta ankimore si në këtë ankesë, pa dhënë sqarime konkrete për arsyet e refuzimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore - Në lidhje me pretendimet ankimore të OE për përshtatje të specifikimeve teknike për prodhuesit CISCO dhe IBM, eksperti teknik në bazë të kërkeve të bëra sqaron si në vijim:

I. Nga hulumtimi i bërë, është evidente se në së paku disa pajisje kanë elemente të specifikimeve teknike që janë karakteristike vetëm për produktet e prodhuesit CISCO.

a) Në pajisjet e rrjetës, në specifikat teknike është precizuar elementi (protokolli) NetFlow. Protokoli NetFlow është protokoll i rrjetit i zhvilluar dhe patentuar nga prodhuesi Cisco për përdorim në produktet e këtij prodhuesi. Prodhuesit tjerë kanë protokollet alternative sikurse sFlow të cilin e ka precizuar si mundësi alternative OE ankues.

b) Po ashtu tek specifikimet teknike për pajisjen "CORE Switch" është kërkuar që të ketë protokollet e autentifikimit: Kerberos, RADIUS, Secure Shell (SSH), TACACS+. Marrë parasysh që protokoli TACACS+ është protokoll i zhvilluar nga Cisco dhe është karakteristike për produktet e prodhuesit CISCO si dhe faktin që kërkesa përfshinë 4 protokolle të autentifikimi, kjo kërkesë e kufizon konkurrencën.

Andaj, rekomandohet që të eliminohen specifikimet që mund të jenë diskriminuese për OE ankues dhe OE tjerë të interesuar në lidhje me këtë aktivitet.

Gjithashtu, kërkesa e AK-së ... "OE, përkujdesuni që produktet e ofruara të jenë ekuivalente ose të barasvlefshme me Specifikat Teknike paraqitur në këtë Dokument Tenderik. (faqe 19-50)", i dhënë në faqen 19 të dosjes së tenderit, duhet të riformulohet konform Nenit 28 të LPP-së, paragrafit 7.

II. Në lidhje me pretendimin se futja e të gjitha pajisjeve bashkarisht (pajisjeve në kuadër të zgjerimit të infrastrukturës ekzistuese dhe pajisjeve të reja) e ngushton konkurrencën, sqarojmë:

Në këtë aktivitet janë kërkuar pajisje të natyrës së njëjtë (Teknologjisë Informative), përkundër që ndarja në lote do të siguronte një pjesëmarrje më të gjerë dhe konkurrencë më të gjerë, eksperti shqyrtues sqaron se ndarja në lote sipas Neni 27/A të LPP-së dhe Nenit 19, paragrafi 1 të RRUOPP-së, ndarja e kontratave në lote është përgjegjësi e AK-së.

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues / teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "Virtuo" O.P, të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të obligohet AK që të përmirësoj specifikimet teknike në aneksin 1, të dosjes së tenderit, në pajtim me Nenin 28 të LPP-së. Gjithashtu AK duhet ti njoftoi operatorët ekonomik të interesuar me ndryshimet e dosjes së tenderit dhe të bëj zgjatjen e afatit.

Operatori ekonomik, përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues, përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 26.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, eksperti teknik dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Fetoshi deklaroi: Ne kemi parashtruar ankese kundër njoftimit për kontrate për shkak se spec.teknike janë përshtatur për prodhues te caktuar konkretisht për CISKO dhe IBM. Faktin e përshtatjes se spec.teknike e ka cekur edhe eksperti teknik me te cilin konstatim ne pajtohemi. Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 28 të paragrafit 2 te LPP-së, sepse aty parashihet se spec.teknike nuk lejohen te vendosen dhe te kërkohen ne atë mënyrë qe favorizojnë apo diskriminojnë OE te caktuar gjithashtu veprimi i Autoriteti Kontraktues bie ndesh me nenin 20.8 te RrUOPP-së sepse spec.teknike janë referuar prodhueseve te caktuar dhe nuk janë shoqëruar me fjalët e barasvlershme dhe ekuivalente dhe me këtë rast nuk ju ofrohet qasje te barabartë te gjithë ofertueseve potencial te këtë aktivitet te prokurimit. Ne para se te bëjmë kërkesë për rishqyrtim kemi bre edhe pyetje sqaruese ne lidhje me këto çështje dhe këto specifikime mirëpo nuk kemi marrur përgjigje konkrete dhe te qarta. Si psh.: tek pyetja nr 5. Kemi kërkuar sqarim qe produktet ne këtë aspekt a mund te lejohen te barazvlefshme dhe te teknologjisë se njëjte mirëpo nuk kemi marrur përgjigje te qarte se a lejohet apo jo. Këtë AP ne kërkojmë qe te ndahet ne lote dhe te ndryshohen spec.teknike me qellim qe te lejohet qasje e barabartë për te gjithë ofertuesit potencial mirëpo ndarjen ne lote e kërkojmë për arsye se

ne këtë AP përveç zgjerimit të infrastrukturës ekzistuese të cilat mund të jene të një prodhuesi ka edhe furnizime e pajisje përcjellëse që mund të jene nga prodhues të tjerë dhe mund të funksionojnë pa ndryshuar funksionimin e rregullt të rrjetit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Ramadani deklaroj: Pajtohem i pjesërisht me mendimin e ekspertit, në lidhje me pretendimet e spec teknike ku OE në fjale mendon se është bërë diskriminim në të gjitha këto kemi që të jene të barazvlefshme që bie ndesh me OE. Sa i përket kërkesë për rishqyrtim OE ankues i ka marrur të gjitha përgjigjet nga Autoriteti Kontraktues. Për aspektin e loteve nuk pajtohem i te ndahet ky AP në lote.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtues znj. Saramati deklaroj: Qëndroj prapa ekspertizës.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues Teknik z. Spahiu deklaroj: Qëndrojmë prapa raportit të dorëzuar në ekspertizë. Në lidhje me pretendimet ankimore të OE për përshtatje të specifikimeve teknike për prodhuesit CISCO dhe IBM, eksperti teknik në bazë të kërtime të bëra sqaron si në vijim:

Nga hulumtimi i bërë, është evidente se në së paku disa pajisje kanë elemente të specifikimeve teknike që janë karakteristike vetëm për produktet e prodhuesit CISCO.

a) Në pajisjet e rrjetës, në specifikat teknike është precizuar elementi (protokolli) NetFlow. Protokoll i NetFlow është protokoll i rrjetit i zhvilluar dhe patentuar nga prodhuesi Cisco për përdorim në produktet e këtij prodhuesi. Prodhuesit tjerë kanë protokollet alternative sikurse sFlow të cilin e ka precizuar si mundësi alternative OE ankues.

b) Po ashtu tek specifikimet teknike për pajisjen "CORE Switch" është kërkuar që të ketë protokollet e autentifikimit: Kerberos, RADIUS, Secure Shell (SSH), TACACS+. Marrë parasysh që protokoll i TACACS+ është protokoll i zhvilluar nga Cisco dhe është karakteristikë për produktet e prodhuesit CISCO, kjo kërkesë e kufizon konkurrencën.

Andaj, rekomandohet që të eliminohen specifikimet që mund të jenë diskriminuese për OE ankues dhe OE tjerë të interesuar në lidhje me këtë aktivitet.

Në lidhje me pretendimin se futja e të gjitha pajisjeve bashkërisht (pajisjeve në kuadër të zgjerimit të infrastrukturës ekzistuese dhe pajisjeve të reja) e ngushton konkurrencën, ne e kemi sqaruar se ndarja në lote sipas Neni 27/A të LPP-së dhe Nenit 19, paragrafi 1 të RRUOPP-së, është përgjegjësi e AK-së. Më tej marrë për bazë faktin se AK ka deklaruar se ky aktivitet ka të bëjë me instalimin konfigurimin dhe integrimin e pajisjeve, ne nuk mund të detyrojmë AK të ndaj në Lote.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Fetoshi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe të detyrohet Autoriteti Kontraktues që ti largoj dhe evitoj kërkesat dhe specifikimet që janë në favor të ofertuesve të caktuar dhe kërkojmë që ky aktivitet i prokurimit të ndahet në lote me qëllim për të hapur konkurrencë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues "Virtuo" O.P- Prishtinë, pretendon se autoriteti kontraktues AKKVP, gjatë përpilimit të specifikave teknike në Dosjen e Tenderit, ka bërë përshtatje të specifikimeve teknike për prodhuesit CISCO dhe IBM.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertit shqyrtues sqaron si në vijim:

I. Nga hulumtumi i bërë, është evidente se në të paku disa pajisje kanë elemente të specifikimeve teknike që janë karakteristike vetëm për produktet e prodhuesit CISCO.

a) Në pajisjet e rrjetës, në specifikat teknike është precizuar elementi (protokolli) NetFlow. Protokollin NetFlow është protokoll i rrjetit i zhvilluar dhe patentuar nga prodhuesi Cisco për përdorim në produktet e këtij prodhuesi. Prodhuesit tjerë kanë protokollet alternative sikurse sFlow të cilin e ka precizuar si mundësi alternative OE ankues.

b) Po ashtu tek specifikimet teknike për pajisjen "CORE Switch" është kërkuar që të ketë protokollet e autentifikimit: Kerberos, RADIUS, Secure Shell (SSH), TACACS+. Marrë parasysh që protokollin TACACS+ është protokoll i zhvilluar nga Cisco dhe është karakteristikë për produktet e prodhuesit CISCO si dhe faktin që kërkesa përfshinë 4 protokolle të autentifikimi, kjo kërkesë e kufizon konkurrencën.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar dhe rekomandohet që të eliminohen specifikimet që mund të jenë diskriminuese për OE ankues dhe OE tjerë të interesuar në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Gjithashtu, operatorët ekonomik të kenë parasysh se që produktet e ofruara të jenë ekuivalente ose të barasvlefshme me Specifikat Teknike paraqitur në këtë Dokument Tenderik, (faqe 19-50)", i dhënë në faqen 19 të dosjes së tenderit, duhet të riformulohet konform Nenit 28 të LPP-së, paragrafit 7.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Virtuo" O.P- Prishtinë, se futja e të gjitha pajisjeve bashkarisht (pajisjeve në kuadër të zgjerimit të infrastrukturës ekzistuese dhe pajisjeve të reja) e ngushton konkurrencën.

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertit shqyrtues konstaton se në këtë aktivitet janë kërkuar pajisje të natyrës së njëjtë (Teknologjisë Informative), përkundër që ndarja në lote do të siguronte një pjesëmarrje më të gjerë dhe konkurrencë më të gjerë, prandaj ndarja në lote dhe ndarja e kontratave në lote sipas Neni 27/A të LPP-së, dhe Nenit 19, paragrafi 1 të RRUOPP-së, është përgjegjësi e autoriteteve kontraktuese.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh sqarimet e dhëna si me lart konstaton se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit ka vendosur kërkesë në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së, ku këto nene kanë përcaktuar se autoriteti kontraktues duhet të përpiloj specifika teknike të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa ma të mire për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar me qëllim për të ndaluar autoritetin kontraktues që të hartojnë specifika teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose me shumë operator ekonomik, andaj AK AKKVP, është i obliguar që ti përmirësoj kërkesat/specifikacionet teknike konform dispozitave të cekura si më lart, duke vepruar në pajtim me sqarimet e dhëna nga eksperti i jashtëm teknik konform nenin 57.3 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës
- 1x1 OE - "Virtuo" O.P- Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.